

VENDIM
Nr. 1000, datë 9.12.2020

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 47, DATË 22.1.2020, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E
NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR VITIN
2020, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 12, të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 1, të vendimit nr. 47, datë 22.1.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në nënndarjen “Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale” emërtesa “... specialist (mjek/stomatolog/farmacist/shëndet publik/technik i shkencave mjekësore) ...” e 700 punonjësve të kontraktuar pranë drejtorive rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, zëvendësohet me emërtesën “... specialist/mjek/stomatolog/farmacist/shëndet publik/technik i shkencave mjekësore/technik i specialiteteve të tjera/shofer ambulance/sanitar .”.

b) Në nënndarjen “Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”, numri i punonjësve në agjencitë rajonale të shërbimit veterinar dhe mbrojtjes së bimëve, për emërtesën “... specialist veteriner ...” bëhet 204 punonjës dhe për emërtesën “... teknik i mesëm/veteriner ...” bëhet 96 punonjës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe